

KONTRATË SHIT - BLERJE
KUOTA KAPITALI

Në Durrës, më 21 Gusht 2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë) në selinë e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "DI TUTTO ITALIANO", regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIUS (NIPT) L82428505P; me seli në DURRES Lagjia nr.14, Shkozot, Rruga Martin Camaj, objekt me nr pasurie 5/1964, zona kadastrale 8515
palët ose përfaqësuesit e palëve;

1

- (1) **Zonja LIZHANA KUMARAKU** e dt.22.06.1959, banuese ne Durres, ID F95622032F madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, *këtu e në vazhdim do të quhet "shitësi"*; dhe
- (2) **Zoti ANTONIO CRISPINO** i dt.15.06.1951, shtetas italian karte ID AR5844674 madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, *këtu e në vazhdim do të quhet "blerësi"*;

MEQENËSE EKZISTOJNË KËTO KUSHTE PARAPRAKE;

- (3) **Bazuar në Ekstraktin e Regjistrimit Tregëtar** rezulton se më 28.12.2018 është themeluar **Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "DI TUTTO ITALIANO"** regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIUS (NIPT) L82428505P, me kapitalin e regjistruar në shumën lekë 100.000 leke (njëqindmijeleke) i paguar plotësisht;
- (4) **Asambleja Përgjithshme e ortakëve të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "DI TUTTO ITALIANO"** ka miratuar shitjen e kuotave të kapitalit;

DUKE MARRË PARASYSH SA MË SIPËR, PALËT BIEN DAKORD SA VIJON:


NENI 1

TITULLI PRONËSISË MBI KUOTAT E KAPITALIT

Ortaku LIZHANA KUMARAKU, zotëron 1 (një) kuotë të zakonshme në kapitalin e regjistruar të shoqërisë me kontributin në shumën lekë 40 000 (dyzetemije) me pjesmarjen në përqindje 40 % (dyzet përqind) të kapitalit regjistruar të shoqërisë, provuar nga Ekstrakti Historik lëshuar nga Qendra Kombëtare Biznesit.

NENI 2

OBJEKTI I KONTRATËS
DHE VLEFTA SHITJES E KUOTAVE TË KAPITALIT



Me këtë Kontratë,

- (1) **Pala Shitëse Lizhana Kumaraku**, i shet blerësit Antonio Crispino 1 (një) kuotë (nje pjese nga kjo kuote) të zakonshme në kapitalin e regjistruar të shoqërisë me kontributin në shumën lekë 14000 (katërmbedhjetemije) ne 14 % të kapitalit

regjistruar të shoqërisë, të lira nga çdo barrë. Me kryerjen e këtij transaksioni, Ortaku Antonio Crispino, mbetet zotërues të 1 (një) kuotë të zakonshme në kapitalin e regjistruar të shoqërisë me kontributin në shumën lekë 14.000 (katëmbdhjetemijë) me pjesmarjen në përqindje 14 % (tetë përqind) të kapitalit regjistruar të shoqërisë, se bashku me kapitalin e mbetur që disponon në këtë shoqëri

NENI 3

DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT

2

Shitësi, me anë të kësaj Kontrate deklaron dhe garanton në lidhje me Shoqërinë si dhe me Transaksionin dhe për të gjitha çështjet që që parashikohen në këtë Kontrate. Shitësi, gjithashtu deklaron dhe garanton se ka vënë në dispozicion të gjithë informacionin përkatës për Shoqërinë për qëllimet e Transaksionit. Shitësi gjithashtu garanton se çdo garanci dhe deklaram do të jetë i vërtetë, i saktë dhe jo i keqpërdorur.

LLOGARITË

Llogaritë e Shoqërisë të Datës së Fundit Kontabël që janë vënë në dispozicion përfituesit, janë përgatitur në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me Parimet e Përgjithshme të Kontabilitetit të pranuar në Shqipëri.

REGJISTRAT KONTABËL DHE LIBRA TË TJERË TË SHOQËRISË

Regjistrat kontabël dhe librat e Shoqërisë janë të azhornuara, mbahen në mënyrën e duhur dhe të gjitha regjistrimet në këto regjistra dhe libra kontabël janë mbajtur rregullisht dhe në përputhje me ligjet Shqiptare dhe me standartet, parimet dhe praktikatat e zbatueshme të vendit.

AKTIVET E TRUPËZUARA

Shoqëria ka titull pronësie të plotë, të mirë, të regjistruar dhe të tregtueshëm mbi të gjitha asetet dhe pronat e saj, që pasqyrohen në Llogaritë e Datës së Fundit Kontabël apo që janë fituar pas kësaj date dhe ky titull nuk është objekt i ndonjë kufizimi, hipoteke, pengu, barre, detyrimi ose të drejte të çfarëdo lloji në përfitim të palëve të treta.

AKTIVET E PATRUPËZUARA

Shoqëria është pronarja e vetme patentat, emrat tregtarë, njohuri teknike (know-how) të saj si dhe çdo të drejtë tjetër të pronësisë industriale ose intelektuale të saj të nevojshme për kryerjen e Aktivitetit të saj, ("Aktivet e Patrupëzuara") dhe nuk është në shkelje të asnjë prej Aktiveve të Patrupëzuara të saj. Këto Aktive të Patrupëzuara janë plotësisht të përdorshme nga ana e Shoqërisë pa qenë nevoja për pagimin e ndonjë liçense, tarife ose ndonjë detyrimi tjetër të ngjashëm.

GARANCITË, DETYRIMET DHE DËMSPËRBLIMET

Shoqëria nuk ka asnjë detyrim të papaguar dhe nuk ka rënë dakord të krijojë ose të marrë hua, të marrë borxh ose detyrime të natyrës së huamarrjes, nuk ka asnjë detyrim të papaguar dhe nuk ka rënë dakord të krijojë ose të marrë hua, të marrë borxh ose detyrime të natyrës së huamarrjes.

DI TUTTO ITALIANO
NUIS: L82428505P
MERCATINO USATO
SHKOZET - DURRËS

Shoqëria nuk është palë dhe nuk është përgjegjëse në bazë të ndonjë marrëveshjeje siguroese, dëmshpërblimi ose marrëveshjeje tjetër për të siguruar ose marrë përsipër ndonjë detyrim financiar ose detyrim tjetër në lidhje me detyrimet e një pale të tretë.

Neni 4

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palet do të bëjnë përpjekjet maksimale që të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga kjo Kontratë, zbatimi dhe interpretimi i saj, të zgjidhen me mirekuptim. Për të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin apo janë në lidhje me këtë Kontratë, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata Shqiptare e Juriksionit.

Neni 5

Të ndryshme

Kjo Kontratë është shkruar në gjuhën shqipe, në dy kopje, ku secila prej tyre e nënshkruar dhe e dorëzuar në këtë mënyrë do të quhet origjinale. Kjo Kontratë nënshkruhet rregullisht me vullnetin e lirë dhe të plotë të palëve;

PALET

SHITËSI

BLERËSI

CRISPIRU ATOATO
Emër, mbiemër e nënshkrimi

(dizbana kumanaku)
Emër, mbiemër e nënshkrimi

In peaktiye ne gjuhen Italiane.

dizbana kumanaku
[Signature]

DI TUTTO ITALIANO
NUI: L82428505P
MERCATINO USATO
SHKOZET - DURRËS